



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE DHE E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

RELACION

“PËR DHËNIEN ME HUAPËRDORJE SHOQATËS JOFITIMPRURESE “ALEANCA FRANCEZE” KORÇË, TË PASURISË 2/539 - ND ZK 8564 NDËRTESE NË “ISH GODINA E BASHKISË KORÇË”, SIPAS GENPLANIT BASHKANGJITUR

Bashkia Korçë ka në pronësi ambientet ku zhvillon aktivitetin Aleanca Franceze Korçë, identifikuar me nr.pasurie nr. 2/539-ND ZK 8564, e llojit ndërtesë, me sipërfaqe sipas genplanit bashkangjitur ketij relacioni, me adrese Rruga 28 Nëntori, Korçë, në bazë të VKM nr.221 datë 21.03.2017 “Për disa ndryshime në Vendimin nr.1532 datë 19.11.2008 të Këshillit të Ministrave Per miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Korçë, të Qarkut të Korçës” (Nëpërmjet kësaj VKM-je ambientet ku ka ushtruar funksionet Gjykata e rrethit Korçë i kaluan në pronësi institucionit të Bashkisë Korçë, me kontratë shkëmbimi me Ministrinë e Drejtësisë nr.1742 Rep.datë 29.06.2009).

Në këtë objekt ka ushtruar veprimtarinë Shoqata jo fitimprurëse Aleanca Franceze me Nipt: L942121310, nëpërmjet kontratës së huapërdorjes datë 24.06.2013, nënshkruar midis Bashkisë Korçë dhe Aleancës Franceze. Afati i kësaj kontrate ka përfunduar.

Ambientet e përdorura nga Aleanca Franceze ndodhen në një pjesë të godinës ku aktualisht zhvillon aktivitetin administrativ Këshilli i Qarkut Korçë. Sipas VKM nr. 601, datë 31.08.2016, godina ku ushtronte veprimtarinë Bashkia Korçë i është transferuar në pronësi Këshillit të Qarkut, përveç pjesës ku ushtron veprimtarinë Aleanca Franceze, e cila ka mbetur në pronësi të Bashkisë Korçë. Ndërkohë, Këshilli i Qarkut ka iniciuar procedurat për transferimin në pronësi të pjesëve të mbetura të godinës në favor të tij, duke ndjekur procedurat pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

Në këtë kontekst, deri në miratimin e VKM-së për transferimin e pronësisë në favor të Këshillit të Qarkut, ambientet ku ushtron aktivitetin Aleanca Franceze mbeten në pronësi të Bashkisë Korçë dhe si rrjedhojë, dhënia e tyre me huapërdorje kërkon miratimin e Këshillit Bashkiak Korçë. Për këtë arsye, propozohet që kontrata e huapërdorjes të jetë me afat deri në 5 (pesë) vjet, por jo më gjatë se momenti i transferimit të pronësisë së godinës në favor të Këshillit të Qarkut, në rast se kjo ndodh brenda periudhës së përcaktuar. Në këtë rast, kontrata do të përfundojë automatikisht.

Aleanca Franceze në Korçë ka luajtur një rol të rëndësishëm në promovimin e kulturës dhe gjuhës franceze, duke organizuar aktivitete edukuese, artistike dhe sociale që kontribuojnë në zhvillimin kulturor të komunitetit lokal. Përmes kurseve të gjuhës, ekspozitave, seminareve dhe aktiviteteve ndërkulturore, kjo organizatë ka krijuar ura bashkëpunimi mes Francës dhe qytetit të Korçës. Duke qenë një qendër aktive e shkëmbimit kulturor, aktiviteti i saj përputhet me interesin publik dhe promovon vlerat e edukimit dhe diversitetit.

Në këtë kuadër, propozohet dhënia me huapërdorje e ambienteve në pronësi të Bashkisë Korçë, duke përmbushur qëllimet e përbashkëta për zhvillimin e komunitetit.

Bazuar në nenin 9 pika 1.2 gërmat a) “njësitë e qeverisjes vendore ushtrojnë të drejtën e pronësisë ... ato fitojnë, shesin dhe japin në përdorim pronën e tyre të paluajtshme sipas mënyrës së përcaktuar në ligj” dhe c) “e drejta e pronësisë ushtrohet nga këshilli përkatës” dhe pika 1.6 gërma a) “e drejta e lidhjes së kontratës” si dhe gërma e/1 e nenit 54 “Këshilli i Bashkisë miraton tjetërsimin e pronave të tretëve” të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” si dhe bazuar në nenet 901-912 të Kodit Civil i propozojmë Këshillit Bashkiak Korçë të miratojë dhënien në përdorim me kontratë huapërdorje të pasurisë nr.2/539-ND ZK 8564, identifikuar sipas genplanit bashkangjitur këtij relacioni, në favor të Shoqatës jofitimprurëse Aleanca Franceze Korçë, në vashdimësi të marrëveshjes së lidhur në vitin 2013, me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së përdorimit të objektit sipas misionit të kësaj shoqate. Kontrata e huapërdorjes do të ketë një afat 5 vjeçar, por jo më gjatë se momenti i transferimit të pronësisë së godinës në favor të Këshillit të Qarkut, në rast se kjo ndodh brenda periudhës së përcaktuar. Në këtë rast, kontrata do të përfundojë automatikisht.

Bashkangjitur këtij relacioni:

- Gen-plan i pasurisë nr.2/359 - ND ZK 8564

DREJTORE E PËRGJITHSHME JURIDIKE
Anxhela (Dishnica) Qeramixhi

KRYETARI

Sotiraq FILO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK

P/V E N D I M

Nr. _____ datë _____ 2024

“PËR DHËNIEN ME HUAPËRDORJE SHOQATËS JOFITIMPRURESE “ALEANCA FRANCEZE” KORÇË, TË PASURISË 2/539 - ND ZK 8564 NDËRTESË NË “ISH GODINA E BASHKISË KORÇË”, SIPAS GENPLANIT BASHKANGJITUR

Këshilli i Bashkisë Korçë, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme Juridike bazuar në dispozitat e neneve 9 pika 1.2 gërmat a) dhe c); ne nenin 54 pika 1.6 gërma a dhe gërma e/1 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” si dhe bazuar në nenet 901-912 të Kodit Civil; bazuar në VKM Nr.1532 datë 19.11.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Korçë të Qarkut të Korçës”:

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I

1. Miratimin e dhënies me huapërdorje, pa kundërshtëpërblim, në favor të Aleancës Franceze Korçë, me Nipt: L942121310, të pasurisë nr. 2/539 - ND ZK 8564 “Ish godina e Bashkisë Korçë” me adresë Rruga 28 Nëntori, Korçë, *sipas genplanit bashkangjitur*.
2. Të autorizohet Kryetari i Bashkisë të nënshkruajë kontratën e huapërdorjes, për një afat deri në 5 (pesë) vjet.
3. Kjo kontratë do të përfundojë automatikisht, në datën e hyrjes në fuqi të aktit nënligjor të transferimit të pronësisë së godinës në favor të Këshillit të Qarkut, në rast se kjo ndodh brenda periudhës së përcaktuar.
4. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

K R Y E T A R

ANA VERUSHI

Miratuar me _____vota

Vota Pro _____

Vota Kundër _____


Vota Abstenim _____

Zbardhur më datë _____

Ambiente në pronësi të Bashkisë Korçë që i kalojnë në përdorim Aleancës Francese, Dega Korçë

Sip = 128 m²

Adresa: L. 7 ,Rr. 28 Nentori, Korçë



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA KORÇE

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT, DHE
KONTROLLIT TE ZHVILLIMIT
TE TERRITORIT

OBJEKTI : AMBIENTE TEK ISH GJYKATA KORÇE

Emertimi: PLANIMETRIA E KATIT TE OYTE

Data: 2013

DREJTORI I D.P.K.ZHT

DREJTORI I D.P.K.ZHT

ZIJANHETA LIPOVAJA

AUTORET
E PROJEKTTIT

ARKITEKT: HENRI NURIE